

**STATUT I SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "FS TRADING" SH.P.K.**

Ne kete statut

-"Ligi" eshte Ligj i Nr. 9901.dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ndyshuar; "Statuti" eshte Statuti i shoqerise "FS TRADING"SHPK.

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZG.JATJA, SELIA**

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot. me date 12 Maj 2023 une Fatos Shahini, atesia, Shahin. datelindja 20.05.1974, lindur ne Rripe, Mat dhe banues ne Rripe, Rruga Shahinaj, Ndertesa Nr.5 me numer leternjoftimi 038905306 dhe Nr personal H40520008G, madhor e me zotesi te pote juridike dhe zotesi te pote per te vepruar, me shtetesi Shqiptare, vendos themelin e Shoqerise "FS TRADING" SH.P.K.

Themelues i shoqerise eshte **FS TRADING**, ortak i vetem dhe administrator i Shoqerise:

Neni 2

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Diber, Mat, Gurre, Fshati Rripe, Rruga Shahinaj, Ndertese private Nr.5. Shoqeria mund te krijoje dege (filiale) ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne Shtete te tjera, ne perputhje me legjislacion in e vendeve perkatese.

Shqiperi. nurnri i celularit per kontakt eshte +355688087408.

Adresa e shoqerise per qellim komunikimi elektronik eshte si vijon: fshahini10@proton.me

**Neni 3
Objekti**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

"Ushtrim te veprimtarise se transferimit te parave. Transferta bankare te pakushtezuara. Shkembime te kriptovalutave"

**Neni 4
Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

KREU II KAPITALI

**Neni 5
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 100.000 Leke.



Kontribut i i ortakut te vetem eshte ne para qe do te mbahet ne arken e Kompanise.

Neni 6:
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise zmadhohet nepërmjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga QKB-ja kompetente e nje ekspert i kontributesh sipas kereses se administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per ti rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga ortaku i vetem, i cili merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit me 100% te votave.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi prek ortakun ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqeson.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoquerie me perjegjes i te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve (ortakut te vetem ose ortakeve te rind qe mund te shtohen).

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte aktualisht organi i vetem vendimmarres i Shoqerise.

Ortaku i vetem eshte aktualisht organi i vetem, vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i vetem eshte perjegjes per rnarrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshirnet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja t "c" dhe "d" dhe 'i;" te kesaj pike;

- f) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se perqjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese ne te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e perqjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parshikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e perqjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marrë vendime te vlefshme vetem nëse te gjithe ortaket janë dakrod, per te marre vendime, pavaresisht rregullsise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e perqjithshme mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 70 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e perqjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoquerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e perqjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e perqjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zrnadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshjtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese:

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te lij ;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te pertitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson

Neni 13

Administrimi

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Emerohet si administrator i pare i shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare i asamblese se Pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:

dhe specimenet e nenshkrimit:

Fatos Shahini,

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

Administrantret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise. duke zbaluar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;



- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- e) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise. sic; parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raportojne perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktoreve me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte per gjegjes individualiasht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesid:



b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi çështjet, per te cilat merret vendim;

d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoquerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoquerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoquerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyrë te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoquerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoquerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoquerise;
- d) lejon qe shoqueria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqueria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.
- f) Pervec padise per shlyejjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose sebashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.
- g) Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plete te demit qe i eshte shkaktuar shoquerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkeses se padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV
VITI FINANCIAR -EKSPERTET
Neni 16
Viti Financiar

Viti financiar i Shoquerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, vit i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoquerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17



Ekspertet

Eksperti, kur Shoqeria ploteson kushtet ligjore dhe statutore per te patur ekspert, ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoquerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje veprim te tille i ngarkur nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi balancin e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V

PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQUERISE

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoquerise behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuari ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Registrit";
- e) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoquerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper"

Prishja e shoquerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoquerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2012. "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare" i ndryshuar.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e



legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbtohen dispozitat e ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndyshuar, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo nterpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“FS TRADING” SH.P.K**

FATOS SHAHINI

